ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **622-24-3539-2-1-1**

Sa i përket tenderit për: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**

1. **Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK:**

Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr. Ndue Përlleshi K.P. , Lok. Nr.1,Prishtinë

(Adresa)

PRISHTINË — **10000**

(Vendi) — *(Kodi postar)*

049/725-444 — ***044/503503***

(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

Kastriot Asllani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@kosovamed-hc.com

(Adresa elektronike)

19.06.2024

(Data e parashtrimit të kërkesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

Partneri juaj në shëndetësi KOSOVAMED HEALTHCARE 810866759 PRISHTINË

2. **Identifikimi i avokatit**

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT** me datë: **12.04.2024** ka iniciuar aktivitetin e prokurimit me titull të kontratës: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**
si në vijim:

a. Procedurë e hapur,
b. Kontrate publike Kornizë
c. Shërbim, Vlerë e Madhe
d. Vlera e parashikuar e kontratës 900,000.00 euro
e. Kriteri për dhënie të kontratës: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët

Afati i fundit për dorëzim i rregullt, data e dorëzimit 27.05.2024 ora:14:00, Vendi: Komuna e Prizrenit, përmes platformës elektronikë E-prokurimi.

- **Me datë: 07.06.2024 –** Kemi pranuar Vendimin e AK-së, bashkëngjitur ne këtë titull të këtij njoftimi kemi pranuar njoftimin për Letrën standarde te tenderuesin e eliminuar, **sipas formularit B42.**
- **Me datë: 11.06.2024 –** Kemi dorëzuar Kërkesë për Rishqyrtim
- **Me datë: 13.06.2024 –** Kemi pranuar vendimin për Refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim nga AK: Kuvendi Komunal i Prizrenit

***4.* Procesi i Hapjes së tenderëve,** *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. **Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues**

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Të diskriminuar me Vendimin e AK- Autoriteti kontraktues – **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT** dhe në pajtim me nenin 108/A të LPP-së parashtrojmë kërkesë për rishqyrtim kundër**;**

- **Njoftimit për tenderuesin e eliminuar B42 dhe**
- **Njoftimit te Vendimit B58 te AK për rezultatin e tenderit te datës 07.06.2024**

Pretendojmë se **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**, përmes Komisionit për vlerësimin,krahasimin dhe ekzaminimin e tenderit gjatë procedurës së vlerësimit, ekzaminimit dhekrahasimit të tenderit ka bërë shkelje të dispozitave të;

I. Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi LPP-së) dhe atë;

- Neni 1, Qëllimi, par 2 dhe 3.
- Neni 7, Barazia në trajtim/Jo diskriminimi, par 1,2 dhe 6;
- Neni 56, Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave, par 1.1, 1.2 dhe par, 3.
- Neni 59, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 4
- Neni 60, Kriteret për Dhënien e Kontratës, par 1, nen par 1.1
- Neni 108/A, paragrafi 12;

II. Dispozitat e Rregullores nr. 01/2022 të prokurimit publik (në tekstin e mëtejmë do të i referohemi RRPP) dhe atë:

- Neni 40, Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, par 40.2; 40.12 dhe 40.13.
- Neni 26, Grup i Operatorëve Ekonomik par, 26.5 dhe 26.9
- Neni 97, Shkeljet e rënda, par 97.1 nen par (d) dhe (o).

III. UDHËZUESI Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK

- Neni 9. Kriteret e dhënies së kontratës, par 2;

7. **Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet**

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim

E kundërshtojmë në tërësi arsyetimin e AK në letrën standarde për tenderuesin e eliminuar B42, për faktin se arsyetimi i AK sa i përket eliminimit të ofertës tonë është i pa bazuar, jo i mbështetur në dispozita ligjore të LPP-se dhe RrPP, ne tejkalim të kompetencave ligjore, dhe jashtë çdo parimi themelor apo etikes sa i përket objektivitetit, profesionalizmit dhe kompetencës profesionale.

- ✓ **Ne e kundërshtojmë** eliminimin tonë në mënyrë të padrejtë, plotësisht diskriminues dhe arbitrar edhe pse ishim Operatori Ekonomik me çmimin më të ulët të ofertuar me vendim të datës: 07.06.2024 kemi pranuar Letrën standarde si tenderues i Eliminuar, me pretendimin kinse nuk i përmbushim kriteret e kërkuara, përkatësisht: *Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë* dhe *Dëshmia 2. OE duhet të posedojë Certifikatën ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara.*

Vendimi i AK - Prizren, i dt: 07.06.2024

B42 - Letër standarde për *[tenderuesin] [kandidatin]* e eliminuar [4]

07/06/2024

Kuvendi Komunal – Prizren rrug; Remzi Ademaj pn

Nr. i prokurimit:	**622**	**2**	**4**	**3539**	**2**	**1**	**1**

Titulli: Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës

/e nderuar(a) *[Z/Znj]]*
Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, PRISHTNE

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".
[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit]* [*dokumentet parakualifikuese]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM |

***[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzuar]* për këto arsye :**

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. Kërkesa 5.Licensa nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të mjekësisë familjare

- **Operatorit Ekonomik nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, si anëtar i grupit - konzerciumit i mungon LICENSA për për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë si në kërkesën 4. (Kusht profesional i kërkuar në pikën III.2.2 Përshtatshmëria profesionale).**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Dëshmia 2. OE duhet të posedojë Certifikatën ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara.

- **Operatorit Ekonomik nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, si anëtar i grupit - konzerciumit i mungon CERTIFIKATA ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara-Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes shëndetësore socio-mjekësore.**

Së pari Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prizrenit e fillon arsyetimin e eliminimit tonë duke theksuar që anëtari i konzerciumit nuk e plotëson:

- *Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë ,*
- *2. OE duhet të posedojë Certifikatën ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara.*

Mirëpo të dyja këto kritere i përmbush plotësisht lideri i konzerciumit: **KosovaMed Healthcare SH.P.K** dhe kërkesa e autoriteti kontraktues **nuk ka qenë** që në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik duhet ta ketë secili anëtar, andaj jemi eliminuar për kriter që nuk kanë qenë pjesë e Njoftimit për Kontratë dhe Dosjes së Tenderit.

Ne si Operatori Ekonomik me çmimin më të ulët në këtë procedurë prokurimi, ne vijim do t'ju shtjellojmë në detaje në bazë të fakteve dhe provave të argumentuara se jemi eliminuar në mënyrë të padrejtë dhe diskriminuese në kundërshtim me par 1, 2, 4 dhe 6 të nenit 7 të LPP-së.

Provë 1: Dëshmia e kërkuar nga AK - Prizren

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. Kërkesa 5.Licensa nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të miekësisë familiare.	**Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e TVSH-kopje. Evidenca 3 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 4.Certifikata licensa për ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë. Evidenca 5.Certifikata-licensa valide nga MSH për shërbime familjare.**

Provë 2: Dëshmia e kërkuar nga AK - Prizren

Kërkesa 2.Certifikata ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik	**Dëshmia 2. OE duhet të posedojë certifikatë që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara.**

Andaj arsyetimi i juaj në vendimin e AK-së është në kundërshtim me kriteret e përzgjedhjes dhe rrjedhimisht është i pa pranueshëm, diskriminues, skandaloz dhe **në shkelje të dispozitave të nenit 56 par 3, i LPP-së si dhe Nenit 40 par, 40.2, 40,12, 40,13 i RRPP 01/2022** ngase aplikoni kritere shtesë të pa parapara në Noftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit sepse në asnjë rast nuk keni kërkuar që në rast të Grupit të Operatorëve Ekonomik duhet ta përmbush secili anëtar pra na eliminoni për diqka që nuk janë pjesë e kritereve në NJK dhe DT. Për kjartësi citojmë vetëm disa dispozitave ligjore të **RRPP 01/2022,** ku apecifikohet kjartë se Operatori Ekonomik nuk mund të eliminohet për kriteret që nuk kanë qenë të specifikuara në NJK dhe DT si dhe vlerësimi duhet të bëhet vetëm në bazë të kritereve të përcaktuara.

40.12 Tenderuesi nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedura e prokurimit në bazë të ndonjë kërkese apo kriteri <u>që nuk është specifikuar</u> në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.
40.13 AK do t'i vlerësojë dhe krahasojë tenderët e përgjegjshëm sipas kritereve për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin e kontratës / dosjen e tenderit.

Për më tepër në vijim citojmë paragrafin 26.5 dhe 26.9 të nenit 26 të RRPP-së si dhe paragrafin 71.4 të LPP-së sa i përket Grupit të Operatorëve Ekonomik.
''26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifkatën e Regjistrimit të Biznesit. Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca), nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale, ***do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.*** *''*

''26.9 Nëse lënda e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshinë ofrimin e shërbimeve profesionale dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën, mjafton që njëri anëtar i grupit të ketë autorizimin, ***apo mjafton që njëri anëtar i grupit të jetë i licencuar dhe të dorëzoj dëshminë së bashku me dokumentet tjera të tenderit të grupit të operatorëve ekonomik në mënyrë që të konsiderohet se grupi e ka përmbushë këtë kërkesë si tërësi.''***

''71.4 i LPP-së. *Nëse një tender dorëzohet nga një grup i operatorëve ekonomik, secili anëtar i grupit është i obliguar të dëshmojë ose konfirmojë në përputhje me nenin 67 të këtij ligji, se nuk është i përjashtuar nga pjesëmarrja në aktivitetin e prokurimit sipas nenit 65 të këtij ligji.* ***Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas neneve 66.2, 68 dhe 69 të këtij ligji do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.''***

Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prizrenit, gjatë vlerësimit me këto veprime nuk e ka zbatuar nenin 40.6 b) lidhur me nenin 40.7 ii) te RRPP 001/2022 si dhe Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve – Paragrafi 4 i LPP-së, ''Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderin fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin kontratës dhe në dosjen e tenderit.''

- **Njoftimit te Vendimit B58 te AK për rezultatin e tenderit te datës 07.06.2024**

Tutje, pasi kemi kërkuar qasje në dokumente të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për kontratë, **C.I.K** kemi vërejtur se oferta e tij është plotësisht e papërgjegjshme për faktin se **mungojn:**

- **Certifikata e Regjistrimit te Biznesit (ARBK),**
- ***Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë***

Të cilat kanë qenë kërkesa në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit.

Dhe në mungesë të gjithë këtyre dokumenteve të **shpallet fitues një operatorë ekonomik i papërgjegjshëm me çmimin më të lartë** dhe të **eliminohet një operatorë ekonomik i**

përgjegjshëm me çmimin më të ulët, me të vërtetë kjo **është e paprecedentë.**

Provë 3: Dëshmia e kërkuar nga AK - Prizren

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. Kërkesa 5.Licensa nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të mjekësisë familjare.	Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e TVSH-kopje. Evidenca 3 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 4.Certifikata licensa për ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë. Evidenca 5.Certifikata-licensa valide nga MSH për shërbime familjare.

C.I.K, ka dështuar të përmbushë kërkesën e Autoritetit Kontraktues për Certifikatë të Regjistrimit te Biznesit të lëshuar nga (ARBK) dhe në vend të saj **C.I.K**, ka ofruar një
Certifikatë e lëshuar nga Ministria e Punëve të Brendshme, departamenti për Regjistrimin e Organizatave

Joqeveritare, e cila nuk e përmbush kriterin e kërkuar sepse aty është kërkuar **Certifikatë të Regjistrimit te Biznesit të lëshuar nga (ARBK)** dhe jo **Certifikatë nga Regjistri i Organizatave Joqeveritare.**

Madje në këtë pikë, **Kuvendi Komunal i Prizrenit** në kundërshtim me dispozitat e LPP-së, përkatësisht nenit 7 par 1, 2 dhe 6, **aplikon standarde te dyfishta**, sepse gjatë hulumtimit të rasteve në OSHP, për Kuvendin Komunal Prizren, në rastin **OSHP, nr.2023/0523**, ky autoritet kontraktues, aplikon tjera standarde në atë rast, por që ka vepruar drejtë, sepse në këtë vendim është rasti i njëjtë sikur në këtë aktivitet prokurimi, ku një OJQ dështon të përmbush kriterin për certifikatën e regjistrimit të biznesit dhe **refuzohet si e papërgjegjshme nga Kuvendi Komunal i Prizrenit** njëjtë refuzohet edhe nga **eksperti shqyrtues** si dhe në fund edhe nga **Paneli Shqyrtues**.

AK- Kuvendi Komunal i Prizrenit, me datë: 13.06.2024 përsëri aplikoi standarde të dyfishta duke e refuzuar e Kërkesën për Rishqyrtim edhe pse ia bashkangjitem vendimin e OSHP-së. nr.2023/0523, për rastin e njëjtë, ky autoritet me këtë veprim tregoi që nuk ka fare konsistence në vendime dhe nuk i bëjnë përshtypje dispozitat ligjore duke nxjerrë vendime të kundërta për raste krejtësisht të njëjta. Andaj, këto veprime janë krejtësisht tendencioze ndaj kompanisë tonë.

Poashtu, pretendojmë dhe konsiderojmë se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë **C.I.K**, nuk e përmbush kriterin ***Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë*** sepse në ofertën e tij ka prezentuar një Certifikatë e cila nuk figuron në emër të Operatorit Ekonomik **C.I.K**, si dhe kjo Certifikatë nuk është e lëshuar nga Ministria e Drejtësisë siq specifikohet në kërkesën e Autoritetit Kontraktues. Pra Certifikata e prezentuar figuron në emër të Caritas Kosova dhe në asnjë vend nuk figuron emri i OE **C.I.K**,

Shih. Argumentin; Certifikata e prezantuar nga **C.I.K**,



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Departamenti për Politika Sociale dhe i Familjes
Department za Socijalne Politike i Porodicu
Department for Social and Family Policy

Nr. i Licencës: 025/032
Br. Licence:
License No:

CERTIFIKATË LICENCIMI
PËR ORGANIZATA JO QEVERITARE DHE SUBJEKTEVE JURIDIKE PRIVATE QË OFROJNË SHËRBIME SOCIALE DHE FAMILIJARE
CERTIFIKATA LICENCIJE
ZA ORGANIZACIJE NEVLADHNI ORGANIZACIJA I PRIVATNIH LICA KOJI PRUŽAJU SOCIJALNE I PORODIČNE USLUGE
LICENSING CERTIFICATE
ON LICENSING OF- NON GOVERNMENTAL ORGANIZATIONS AND PRIVATE LEGAL ENTITIES PROVIDING SOCIAL AND FAMILY SERVICES

Emri i Organizatës/Subjektit Juridik: Caritas Kosova
Naziv Organizacije/Pravno Lice:
Name of Organization/Legal Entity:

Vendi: Ferizaj
Mesto:
Place:

Adresa: Rr. Shënë Nënë Tereza Nr. 3
Adresa:
Adress:

Numri i regjistrimit: 5200022-0
Registarski broj:
Regidtration of number:

Është e licencuar për të ofruar: Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes së drejtëperdrejt sociale në shtëpi, dhe asistencë materiale për persona që nuk mund të kujdesen për veten, të moshuar dhe me aftësi të kufizuara, në nivel nacional.
Licensiran je za pruženje:
Is licensed for the provision:

Licenca vlenë nga: 26/11/2021 deri më: 25/11/2024
Licenca vazi: od do:
License is valid: from to:

Prishtinë, më: 08/12/2021
Pristina, dana
Pristina, date

Drejtor/Direktor/Director
Mehtor Krasniqi
v.v.

Ministri/Ministar/Minister
Per z. Ministrin
Hekurani, Murati
v.v.

Ndërsa në kërkesën tjetër të Autoritetit Kontraktues: *5.Licensa nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të mjekësisë familjare.* Operatori Ekonomik i rekomanduar për Kontratë **C.I.K**, ka prezantuar *Licensën* në emër të C.I.K.

Shih. Argumentin; Certifikata e prezantuar nga **C.I.K**,

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Shëndetësisë-Ministarstvo Zdravstva-Ministry of Health

Licencë - Licenca

Nr./Br.252/2019

" C.I.K "

Ambulancë Specialistike e Mjekësisë Familjare & Ambulancë e Stomatologjisë

Adresa/Adresa: Rr. Dubravë. Ferizaj
Themelues/Osnivač/: Viktor (Dodë) Sopi

18/09/2019 – 17/09/2024
E vlefshme/Vazeća

Z.Isak Shabani
Kryesues i Bordit/Predsednik Odbora

Z.Uran Ismaili
Ministër i Shëndetësisë/Ministar Zdravstva

Pra, si është e mundur që brenda një oferte ky operatorë ekonomikë te kërkesa për *certifikim për ofrimin e shërbimeve sociale* - të prezantojë certifikatën në emër të ''Caritas Kosova'' dhe në kërkesën për *Licensë nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të mjekësisë familjare – të prezentojë licensën në emër të ''*C.I.K''. Andaj nuk mund të ketë të drejtë në të dyja rastet sepse kemi të bëjmë me dy licensa/certifikata të lëshuara në emër të ndryshëm dhe kjo nuk mund të arsyetohet përveq se të shpallet i papërgjegjshëm edhe në këtë pikë, por si duket Autoriteti Kontraktues me apo pa vetëdije edhe në këtë rast i ka mbyllur sytë.

<u>Kujtojmë që emri zyrtar në procesverbalin e hapjes</u> të nënshkruar nga zyrtarët e prokurimit, figuron *C.I.K, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj.*

<u>Kujtojmë që emri zyrtar në formularin e tenderit</u> fihuron *C.I.K, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj.*

<u>Kujtojmë që emri zyrtar në Certifikatën – Deklaruesi TVSH</u> – figuron *C.I.K, Kisha katolike,.Rexhep Bislimi, Ferizaj.*

Pëveq këtyre OE rekomanduar për kontratë *C.I.K*, ka dështuar të pëmbush edhe kërkesën për Certifikatën ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik

Shih. Argumentin: ISO 9001 2015,

TÜVNORD

CERTIFIKATË

Për sistemin e menaxhimit të cilësisë, sipas
ISO 9001 : 2015

Organi certifikues TÜV NORD CERT GmbH konfirmon si rezultat të auditimit, me vendim vlerësimi dhe certifikimi sipas ISO/IEC 17021-1: 2015 që organizata

Caritas Kosova
Rr. Nene Tereza Nr.3
70000 Ferizaj
Kosovo

CARITAS KOSOVA

përdor një sistem menaxhimi në përputhje me kërkesat ISO 9001 : 2015 dhe monitoron për pajtueshmëri brenda afatit të certifikatës prej 3 vitesh.

Fushëveprimi

Kohezioni Social, Perkujdesi Shëndetësor, Edukimi, Punësueshmëria, Asistenca Sociale për njerëzit e margjinalizuar dhe Emergjencat

Numri i regjistruar i certifikatës 44 100 24 32 0039
Numri i raportit 35924 0439

Vlefshme nga 2024-03-27
Vlefshme për të 2027-03-26
Certifikimi i parë 2024

Shërbimi i cili lëshon certifikatën
TÜV NORD CERT GmbH

Plovdiv, 2024-03-27

Kjo Certifikatë përveq që nuk është në emër të OE të rekomanduar për kontratë **këtu shohim se dallon edhe adresa:**

Sepse adresa e *C.I.K, është:*
Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj. *Ndërsa në këtë certifikatë shënon*

*Caritas Kosova është****: Rr, Nnënë Tereza Nr. 3, 70000 Ferizaj***

Prandaj kjo është edhe një pikë qëtregon se me të vërtetë kjo ofertë është totalisht e papërgjegjshme dhe si etillë duhet të trajtohet.

Gjithashtu, pretendojmë dhe konsiderojmë se OE i rekomanduar për Kontratë *C.I.K*, nuk e ka ofruar **Sigurimin e Tenderit** në emër të tij.

Shih. Argumentin; Sigurimi i Tenderit.

Pjesë përbërëse e policës: 050952

Për: KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT
(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues")

Në emër të: CARITAS KOSOVA, KISHA KATOLIKE REXHEP BISLIMI
(në vazhdim "tenderuesi")

VËREJTJE:

Titulli i aktivitetit të prokurimit: BLERJA E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE PËR PËRMBUSHJEN E NEVOJAVE PËR STAF SHTESË TË INSTITUCIONEVE TË KPSH-ËS
Numri i prokurimit: 622-24-3539-2-1-1

SIGURIA E TENDERIT
Garancion me kërkesë të parë

DERISA tenderuesi ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri tenderi duke iu referuar Dosjes së Tenderit, me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE tenderuesi dëshiron të depozitojë garancinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE NE jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci:

ANDAJ NE, me këtë konfirmojmë se jemi Garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të tenderuesit, deri në një total prej: **9,000.00 EURO (NENTEMIJE EURO)** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

(a) Autoriteti kontraktues konstaton, në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht, se ai tenderues i ka dhënë informacione përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese Autoritetit Kontraktues;

(b) Tenderuesi tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në Dosjeje të Tenderit;

(c) Tenderuesit i është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi refuzon apo dështon:
- Që të depozitojë sigurinë e ekzekutimit të specifikuar në Dosjen e Tenderit;
- Të plotësojë të gjitha kushtet që i paraprijnë nënshkrimit të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në Dosjen e Tenderit; apo
- Të lidhë kontratë që u përshtatet afateve dhe kushteve të saktësuara në dosjen e tenderit;

Pagesa në shumën e limituar prej: **9,000.00 EURO** siç është lartcekur, pa pasur nevojë të vërtetoni apo të tregoni arsyet ose shkaqet e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlen 150 ditë
Data e fillimit: 2024-05-27

Emri dhe mbiemri i përfaqësuesit:

SCARDIAN Sigurime
Rr. Perandori Justinian Nr.3
10000 Prishtinë

Dhe në këtë pikë oferta e C.I.K është dashur të shpallet e papërgjegjshme dhe Autoriteti Kontraktues të veprojë në harmoni me nenin **10.1** të **UDHËZUESIT Nr.001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK Citojë:**

Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

Pas paraqitjes së gjitha këtyre argumenteve bindëse AK- Kuvendi Komunal i Prizrenit duhet ta shohë që ka favorizuar **C.I.K** dhe ka diskriminuar kompaninë tonë **KosovaMed Healthcare SH.P.K.** si dhe në mënyrë jo të drejtë të gabuar dhe të një anshme ka nxjerr vendim duke shpallur fitues OE me çmim më të lartë në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së, Neni 1, par 2 dhe 3. Neni 7, par 1,2 dhe 6. Neni 51, par 3. Neni 56, par 1.1, 1.2. Neni 59, par 4.

Pra, AK – Kuvendi Komunal i Prizrenit, përveq që ka eliminuar ofertën tonë të përgjegjshme me çmim më të ulët, ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik të papërgjegjshëm me çmim më të lartë.

Përkundër argumenteve dhe provave të paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim të datës: 11.06.2024 se jemi eliminuar në mënyrë të padrejtë me një vendim jashtë çdo parimi themelor apo etikes sa i përket objektivitetit dhe profesionalizmit. Autoriteti Kontraktues, merr vendim për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim duke mos dhënë vetë disa arsye gjysmake dhe të pa kjarta që bie ndesh me nenin 108/A, paragrafi 12, i cili citon *'' Kundërshtimet dhe vendimet e miratuara në përputhje me paragrafët 8 dhe 10 të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe ti komunikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë''.*

Tani në përgjigjen e Kërkesës për Rishqyrtim Autoriteti Kontraktues thekson se jemi eliminuar duke u thirrë në nenin 66 të LPP-së vetëm në këtë pikë si në vijim:

- Pretendimi i OE ankues, lidhur me Kërkesën e Autoritetit Kontraktues, në Nioftimin në Kontratë Certifikatë-Licenë për ofrimin e shërbimeve sociale tek Përshtatshmëria Profesionale është JO i bazuar.

Grup i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K. kan aplikuar si grup për këtë projekt, ndërsa OE nDONA SH.P.K. si anëtar i konzorciumit nuk është i licensuar dhe nuk posedon në dosje e tij certifikatën-licensën nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e shërbimeve sociale për këtë projekt shëndetësor.

Me rastin e krijimit të Konzerciumit tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara me nenin 66 të LPP-së të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues duhet të plotësohen nga të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë individuale.

Mirëpo ne i bëjmë me dije Autoritetit Kontraktues - Kuvendi Komunal Prizren se aktiviteti i prokurimit që keni shpallur është kontraktimi i një Operatori Ekonomik për *Ofrimin e shërbimeve Profesionale* dhe pikërisht për nenin 66 të LPP-së, në mënyrë decidive dhe shumë të kjartë na sqaron paragrafi, 26.5 i nenit 26 të RRPP-së. Cituar'' *''26.5 Secili anëtar i grupit individualisht duhet të dorëzoj Çertifkatën e Regjistrimit të Biznesit.* ***Çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit 66.2 (Autorizimi/Licenca),*** *nenit 68 të LPP-se, gjendja ekonomike dhe financiare dhe nenit 69 të LPP-se aftësia teknike dhe/ose profesionale,* ***do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.*** *''*

Citojmë nenin 66.2 ''*Nëse lëndë e aktivitetit të prokurimit është kontrata publike që përfshin ofrimin e shërbimeve profesionale, dhe nëse këto shërbime i takojnë llojit që normalisht mund të ofrohen vetëm nga operatori ekonomik që ka autorizimin ose licencën e autoritetit publik ose që është anëtar i organizatës së caktuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të ofrojnë dëshmi të arsyeshme se ata kanë autorizimin ose licencën e tillë ose se janë anëtarë në vendin e tyre të themelimit ose deklaratën nën betim se një kërkesë e tillë nuk ekziston në vendin e tyre të themelimit.''*

Këtu shohim nënyrë të kjartë se në këtë pikë, Autoriteti Kontraktues ka vepruar *në kundërshtim me* ***par, 71.4 të LPP-së*** *si dhe par,* ***26.5 i nenit 26 të RRPP-së*** sepse aty sqarohet se *çdo kërkesë e vendosur nga një autoritet kontraktues sipas nenit* ***66.2*** *(Autorizimi/Licenca), do të aplikohen vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit.''*

Për me tepër, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të plotë dhe në shkelje të dispozitave të nen par (d) dhe (h) dhe të par 97.1 të nenit 97 të rregullores 01/2022, për shkak të mos respektimit dhe shkeljeve të parimeve themelore të prokurimit publik të përcaktuar me LPP dhe ne trajtim jo të barabartë të ofertuesve gjatë ushtrimit të procedurave të prokurimit, për shkak të sjelljeve jo profesionale dhe të gabuara të zyrtarit të prokurimit.

Dhe, rrjedhimisht, vendimi i AK është nxjerrë në shkelje të dispozitave Ligjore të LPP-se dhe RrPP, sa i përket kritereve të përzgjedhjes të parapara në njoftim për kontratë dhe dosje të tenderit, sepse shpërblen me kontratë OE të pa përgjegjshëm ne kundërshtim me par 1 të nenin 51, nen par 1.1 dhe 1.2 të par 1 dhe par 6.3 të nenit 56 dhe nen par 1.1 të par 1 të nenit 60 të LPP-se, kurse neve na eliminon padrejtësisht edhe pse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët në pajtim me kriteret e vlerësimit të parapara nga AK, në NJK dhe DT.

Dhe, rrjedhimisht, duke pasur parasysh se, jemi palë me interes juridiko material ne kuptim të nenit 4.1.26 të LPP-se, sepse jemi të përgjegjshëm dhe kemi ofruar çmimin me te ulët, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që Ankesën tonë ta trajton në përputhje të plotë me dispozitat e LPP-se dhe rregulloreve në fuqi dhe argumenteve të prezantuara dhe ta hedh poshtë vendimin e AK-së, me plotë kuptimin e fjalës plotësisht diskriminues, tendencioz dhe të njëanshëm, andaj mbetemi me shpresë që e drejta jonë marrë vendim meritor nga OSHP-ja.

Prandaj, duke u bazuar në faktet, argumentet, arsyetimet, provat materiale, kërkojmë nga Organi Shqyrtues i Prokurimit që pas trajtimit të Ankesës tonë të nxjerr:

VENDIM

- ✓ Të nxjerrë vendim meritor me të cilin të aprovojë Ankesën si të bazuar të paraqitur nga **‘’ Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K**”, Prishtinë

- ✓ Te anuloj vendimin e AK – **Kuvendi Komunal i Prizrenit** të datës 07.06.2024 sepse **’’Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K**, **Prishtinë,** ka dorëzuar tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;

- ✓ Lëndën ta kthejë në Rivlerësim dhe ti jap të drejtë Operatorit të përgjegjshëm me çmim më të ulët: **‘’ GOE KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K**”, **Prishtinë**

Mbetemi me shpresë se Ankesa jonë do të shqyrtohet pozitivisht.
Me respekt,
Kastriot Asllani

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet përveq atyre morale jemi të dëmtuar edhe ne aspektin financiar, shpenzimet në Sigurimin e Tenderit, Ankesat, Dokumentet për përgatitjen e tenderit për konkurim. Dëmit ekonomik dhe financiar i fitimit të planifikuar.

Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.
f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT

NJOFTIM PËR KONTRATË

☐ ***PUNË*** ☐ ***FURNIZIM*** ☒ ***SHËRBIME***

Sipas Nenit 40të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Data e përgatitjes së njoftimit: 12.04.2024

Nr i Prokurimit	**622-24-3539-2-1-1**
Nr i brendshëm	

Ky njoftim është përgatitur në GJUHËT:

Shqip ☒ Serbisht ☒ Anglisht ☒

NENI I: AUTORITETI KONTRAKTUES

I.1) EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

Emri zyrtar: **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**		
Adresa Postare: **Remzi Ademaj**		
Qyteti: **PRIZREN**	Kodi postar: **-20000**	Vendi: **Kosovë**
Personi kontaktues: **Bashkim Zogaj**	Telefoni: **038/20044794**	
Email: **bashkim.zogaj@rks-gov.net**	Faksi:	
Adresa e Internetit (*nëse aplikohet)*:		

Po ☐ Jo ☒

Kontrata përshinë prokurimin e përbashkët

Po ☐ Jo ☒

Kontrata shpërblehet nga Agjencia Qendrore e Prokurimit

Nëse po, specifiko identitetin e të gjithë Autoriteteve Kontraktuese që kanë të drejtë të bëjnë porosi nën termet e kontratës ose referoju një Aneksi:

NENI II: LËNDA E KONTRATËS

II.1) PËRSHKRIMI

II.1.1) Titulli i kontratës i dhënë nga autoriteti kontraktues:
Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës

II.1.2) Lloji i kontratës dhe lokacioni i punëve, vendi i dorëzimit apo realizimit
(Zgjidhni vetëm një kategori - punë, furnizime apo shërbime – e cila korrespondon më së shumti me objektin specifik të kontratës suaj)

☐ **Punë**	☐ **Furnizime**	☒ **Shërbime**
☐ Ekzekutim ☐ Plani dhe ekzekutimi ☐ Realizimi, në çfarëdo mënyre, të punës, përgjegjës me kërkesa	☐ Blerja ☐ Qira financiare (lizing) ☐ Qira ☐ Blerje me këste ☐ Një kombinim i këtyre	

Vendi apo vendndodhja kryesore e punëve/kryesor i dorëzimit/ kryesor i realizimit
QKMF-Prizren

II.1.3) Njoftimi përfshinë

Krijimin e kontratës publike kornizë
☒

II.1.4) Informacionet e marrëveshjes kornizë *(nëse aplikohet):*

Kontrate publike kornizë me një operator
☒

Kontrate publike kornizë me disa operator
☐

Ekzekutimi i kontratës:

Thirrje/Porosi
☒

Kontrata ndihmëse/Mini-konkurencë
☐

Kohëzgjatja e kontratës publike kornizë: në muaj 36

II.1.5) Përshkrim i shkurtër i lëndës së kontratës
Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës

II.1.6) Klasifikimi i Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP):

85111400-4

II.1.7) Variantet pranohen

Po ☐ **Jo** ☒

II.1.8) Ndarja në Pjesë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po, tenderët mund të dorëzohen për *(shënoni vetëm një kuti)*

☐ vetëm një pjesë ☐ Të gjitha pjesët

II.1.9) Informacione lidhur me pjesët (*nëse aplikohen)*

Nr. i pjesës	Emërtimi i grupit	Përshkrimi i shkurtër

Numri maksimal i Pjesëveqë do të mund të shpërblehet tek një tenderues është:

II.1.10) Vlera e parashikuar e kontratës: 900,000.00

II.2) SASIA APO FUSHËVEPRIMI I KONTRATËS

Sasia apo fushëveprimi i përgjithshëm *(përfshirë të gjitha pjesët dhe opsionet nëse aplikohen)*

Shërbimet e kujdesit shëndetësor shtëpiak dhe ambulantor të ofruara nga mjekë të përgjithshëm, si vizitë mjekësore, do të përfshijnë Vizitë mjeksore, marrja e anamnezës, shikimi i dokumentacionit mjekësor ekzistues të pacientit, ekzaminimi i pacientit, matja e tensionit arterial dhe parametrave të tjere vital, përcaktimi i diagnozës, vendosja e menaxhimit të terapisë, edukimi shëndetësor, vendosja e planit të mjekimit, përcjellja e gjendjes shëndetësore të pacientit dhe sipas nevojës udhëzimi për kujdes në nivelin dytësorë dhe tretësor. Vizita mjeksore

Shërbimet infermierore të kujdesit shëndetësor shtëpiak për personat e moshuar dhe te vetmuar me regjim shtrati të kryera në shtëpi të përfituesit do të përfshijnë Përgaditja e pacientit për vizitë mjekësore, matja e shenjave vitale, aplikimi i terapisë orale,dhe parenterale, pastrimi dhe lidhja e plageve, vendosja dhe ndërrimi i kateterëve urinar, oksigjenoterapia, edukimi shëndetësor, ushtrimet pasive dhe aktive si preventive për dekubite, dokumentimi, etj Vizita shtëpiake në teren

• Shërbime infermierore ambulatore te pacientet të kryera brenda institucionetve shëndetësore si në QKMF, AMF,urgjencë etj, sipas përshkrimit në seksionin III (përshkrimi i shërbimit), brenda periudhës së kontraktuar, dhënje injekcioni, vendosje infuzioni, vendosje kateteri, pastrim plage, trajtim dekubiti, të gjitha shërbimet infermieieroe. Shërbime

POZICIONI 1,2,3 Marrja e gjakut për analiza, ruajtja dhe transporti deri në laborator, përpunimi i tyre dhe dorëzimi i rezultateve, për personat në gjendje të rëndë sipas kërkesës dhe udhëzimit të mjekut. Shërbime

Shërbimet sociale do të përfshijnë përmirësim i kushteve jetësore në një mjedis të sigurt dhe të rehatshëm për pacientin me regjim shtrati, duke ndihmuar në mbajtjen e higjienës personale dhe të ambientit të brendshëm të shtëpisë tek personat e moshuar të vetmuar pa

II.3) KOHËZGJATJA E KONTRATËS APO AFATET KOHORE PËR PËRFUNDIM

Kohëzgjatja në muaj apo ditë (nga dhënia e kontratës)

apo Fillimi Përfundimi

NENI III: INFORMACIONET LIGJORE, EKONOMIKE, FINANCIARE DHE TEKNIKE

III.1) KUSHTET NË LIDHJE ME KONTRATËN

III.1.1) Siguria e kërkuar e ekzekutimit **Po** ☒ **Jo** ☐ ***Nëse po***, vlera e sigurisë së ekzekutimit EUR ose **10 % e vlerës së kontratës në afat kohor prej 37 muaj** % e vlerës së kontratës
III.1.2) Forma ligjore që do të merret përmes grupit të operatorëve ekonomik të cilëve do t`u jepet kontrata *(nëse aplikohet)*:
III.1.3) Kushtet e tjera të veçanta me të cilat ka të bëjë ekzekutimi i kontratës **Po** ☐ **Jo** ☒ ***Nëse po,*** përshkrimi i kushteve të veçanta

III.2) KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë: **1. Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr. 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http krpp.rksgov. net**	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:* **1. Deklaratën nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë Neni 65 i Ligjit Nr. 04 L-042 , Plotësimi i Aneksit Nr. 2 te Dosjes se Tenderit 2. Një vërtetim nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit. Kërkohet kopja vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. 3. Një vërtetim nga Gjykata qe vërteton se a. Operatori ekonomik, ndonjë drejtues,menaxher ose drejtor i saj gjatë dhjetë viteve të kaluar nuk a është shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një vepre penale; dhe b. Operatori ekonomik nuk është ne falimentim ose nën administrim te dhunshëm gjyqësore. Për piken (a) dhe (b) Kërkohet origjinali vetëm nga Operatori Ekonomik qe propozohet për shpërblim te kontratës dhe dorëzohet te Autoriteti Kontraktues para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues. Dështimi i Operatorit Ekonomik qe është propozuar qe**

	te shpërblehet me kontrate te sjelle dokumentet te kërkuara ne piken, 2 dhe 3 i jep të drejtë Autoritetit Kontraktues qe ofertën ta refuzoj, te konfiskoj sigurimin e tenderit nëse e njëjta është kërkuar, të inicioj procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-se dhe te vazhdoj me shpërblim te kontratës me Operatorin Ekonomik qe është listuar ne vendin e dyte.
III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. Kërkesa 5.Licensa nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të mjekësisë familjare.	**Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e TVSH-kopje. Evidenca 3 Certifikata e numrit fiskal Evidenca 4.Certifikata licensa për ofrimin e shërbimeve të kërkuara nga Ministria e Drejtësisë. Evidenca 5.Certifikata-licensa valide nga MSH për shërbime familjare.**
III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të shkuara 2021,2022,2023 ka qen prej jo më pak se 1.800,000.00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartësi duhet të plotësojë minimum 60 % lërkesave ekonomiko financiare.	**Evidenca 1 Pasqyrat e qarkullimit financiare të kompanisë, të shoqëruar me qarkullimi financiar nga banka për tri vitet e shkuara 2021,2022,2023 apo deklaratat e tatimeve vjetore të dorzuara në Administratën Tatimore të Kosovës.**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	*Dëshmia e kërkuar dokumentare:*
Kërkes 1. Projektet e natyrës së kontratës realizuara ne tri vitet e shkuara (duke filluar nga koha e publikimit të këtij njoftimi) e vërtetuar nga OE, ku përfshihen titujt e projekteve, numri, data e kontraktimit të standardeve dhe vlerat e tyre, vlera,minimale e të gjitha projekteve të natyrës së kontratës duhet të jetë jo më e vogël se 1.350.000,00 € Në rast të krijimit të konsorciumit OE bartës duhet të plotësojë minimum 60 % të kapacitetit teknik dhe profesionale të referencave të natyrës së kontratës.	**Dëshmia 1 Lista e projekteve te natyrës së kontratës e vërtetuar për tri vitet e fundit nga OE- (e skenuar nga origjinali) për dosien elektronike, , të deshmuara me referenca të cilat dëshmojnë vlerën e shërbimeve dhe natyrën e tyre apo proces verbal të pranimit përfundimtar të furnizimeve-shërbimet**
Kërkesa 2.Certifikata ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik	**Dëshmia 2. OE duhet të posedojë certifikatë që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara.**
Kërkesa 3. Lista e origjinale e stafit e nënshkruar nga Operatori Ekonomik	**Dëshmia 3.Lista e stafit profesionalë me 40 të angazhuar,emri dhe mbiemri,numri i licensës profesionale. - 10 mjekë të përgjthshëm - 25 infermier - 2 punëtor social(licensuar nga MPMS) - 3 laborant.**

III.3) KUSHTET SPECIFIKE PËR KONTRATAT E SHËRBIMEVE

Po ☐ **Jo** ☒

III.3.1)Ekzekutimi i shërbimeve i rezervuar për një profesion të caktuar

Nëse po, referenca për ligjin, rregulloren apo dispozitën administrative përkatëse
III.3.2 Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve **Po** ☐ **Jo** ☒

NENI IV: PROCEDURA

IV.1) LLOJI I PROCEDURËS

IV.1.1) Lloji i procedurës
☒ **E hapur**
☐ **E kufizuar**
☐ **Konkurruese me negociata**
☐ **Kuotim i Çmimit**
IV.1.2)Kufizime në numrin e operatorëve të cilët do të ftohen për tenderim *(procedurë e kufizuar apo konkurruese me negociata)* Në bazë të aplikacioneve të pranuara, më së shumti 6 kandidat do të ftohen për të dorëzuar tenderët e detajuar të kësaj kontrate. Nëse më shumë se 6 kandidat të përshtatshëm i plotësojnë kriteret e mësipërme të përzgjedhjes, përparësitë dhe dobësitë relevante të aplikacioneve të këtyre kandidatëve do të ri-ekzaminohen për të identifikuar gjashtë aplikacionet më të mira për proceduren e tenderit. Të vetmit faktorë të cilët do të mirren parasysh gjatë këtij ri-ekzaminimi janë:
IV.1.3) Reduktimi i numrit të operatorëve gjatë negociatave *(procedurë konkurruese me negociata)* Udhëheq negociatat në faza të njëpasnjëshme **Po** ☐ **Jo** ☐ në mënyrë që të zvogëlohet numri i tenderëve të negociuar Autoritetet kontraktuese mund të shpërblejnë kontratat në bazë të tenderëve fillestarë pa negociata **Po** ☐ **Jo** ☐
IV.1.4 Numri minimal i kandidateve te cilët do te ftohen qe te dorëzojnë **Tenderët fillestar është**:
IV.1.5. Informata ne lidhje me ankandin elektronik Do te përdoret ankandi elektronik: Po ☐ Jo ☒ Informata shtese ne lidhje me ankandin elektronik:

IV.2) KRITERET E DHËNIES

☒ **Çmimi më i ulët** *ose* ☐ **Tenderi ekonomikisht më i favorshëm në drejtim të**

IV.3) INFORMACIONET ADMINISTRATIVE

IV.3.1) Publikimet paraprake në lidhje me kontratën e njëjtë

Po ☐ **Jo** ☒

Nëse po,

Njoftim paraprak: i

Publikime tjera (*nëse aplikohen):*

i

i

Po ☐ **Jo** ☒

Dokumentet me pages

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe metoda e pagesës:

IV.3.2) Afati i fundit për pranim të *tenderëve / aplikacioneve:*

data **27.05.2024** ***koha*** **14:00:00** ***vendi*** **e-prokurimi**

IV.3.3) Afati kohor për dorëzimin e *tenderëve / aplikacioneve* është shkurtuar:

☐ **Po** ☒ **Jo**

Nëse po, jep arsyetim

IV.3.4) A është e nevojshme siguria e tenderit:

Po ☒ **Jo** ☐

Nëse po, vlera e sigurisë së tenderit **9000,00 euro**

Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë **150** *apo* muaj

IV.3.5) Periudha e vlefshmërisë së tenderit:

Deri më: data: ditët **120** apo muajt

IV.3.6) Takimi për hapjen e tenderëve:

data 27.05.2024 koha 14:00:00 vendi Komuna e Prizrenit

NENI V: INFORMACIONET PLOTËSUESE

V.1) ANKESAT

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092ne adresën e specifikuar ne Nenin I te këtij Njoftimi për kontratë.

V.2) INFORMACIONET SHTESË

Shënim: operatorët ekonomik do të kenë të drejtë të dorëzojnë tenderin, kërkesën për pjesëmarrje dhe dokumentet e tjera të nevojshme apo dosjet të cilat u lejohen gjatë kryerjes

së një aktiviteti të prokurimit në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze. *Shto informacione tjera: (si konferenca para-ofertuese, vizita ne punishte etj)*

PROCESVERBALI I HAPJES SË TENDERIT / MINUTES OF TENDER OPENING / ZAPISNIK OTVARANJA TENDERA

Numri i prokurimit Procurement number Broj nabavke:	**622-24-3539-2-1-1**	Titulli i Kontratës Contract Title Naslov ugovoru	**Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**
Numri i brendshëm Internal No Interni broj			

Data e lëshimit Date of issue Datum izdavanja	Data e mbylljes Closing date Datum zatvaranja & Čas	Data e hapjes & Ora Opening date & time Datum Otvaranja & Čas	Vendi Place Mesto	Nr. i tenderëve të pranuar No. of Received Tenders Br. Primljenih Tendera
27.05.2024	**27.05.2024, 14:00:00**	**27.05.2024, 14:00:00**	**Komuna e Prizrenit**	**2**

Nr. Br.	Tenderuesi Tenderer Tenderer	Kodi i tenderit Tender label /code Oznaka ponude	Pjesë Lot Lot	e-tenderit e-tender e-ponuda	Çmimi Price Cena €	Çmimi (me TVSh) Price (with VAT) Cena (sa PDV) €	Ndryshimi/plotësimi Suplement/Amendment Dpuna/Izmjena
1.	**C.I.K, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj**	**003_05_2024**	**Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**	**PO**	**10.32**	**10.32**	**JO**
2.	**Grup i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K., Rr. Ndue Përlleshi K.P. , Lok. Nr.1, Prishtinë, 10.000, PRISHTINË**	**DN270524PZ**	**Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**	**PO**	**4.88**	**4.88**	**JO**

Përfaqësuesi i OE / EO Representative / Zastupnik EO

Nr. Br	Tenderuesi, Emri / Mbiemri Tenderer, Name / Surname Tenderer, Ime / Prezime	Nënshkrimi Signature Potpis

Komisioni i hapjes / Opening commission / Komisija otvaranja

Emri Mbiemri Name Surname Ime Prezime	Nënshkrimi/ Signature/ Potpis	Datë/ Date/ Datum
Alban Susuri		
Bashkim Zogaj		
Isa Osmankaj		
Nezir Rexhepi		

Nënshkrimi i Zyrtarit të Prokurimit/ Procurement Officer Signature/ Potpis službenika za javne nabavke:

* Procurement officer shall appoint a tender opening commission.

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

B58 - NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES[1]

Sipas Nenit 43.7 dhe 44.2 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ te Prokurimit Publik

Titulli: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**

Nr. i Prokurimit:	**622**	**24**	**3539**	**2**	**1**	**1**

Nr.	**Emri dhe adresa Operatorëve Ekonomik pjesëmarrës**	**Vlera totale e ofertave**[2]
1.	**C.I.K, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj**	**10.32**
2.	**Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, PRISHTNE**	**4.88**

Rezultati i aktivitetit te prokurimit:

***KOMUNA E PRIZRENIT* shpërblen me kontratë:**

C.I.K, Rr.Rexhep Bislimi, 70000, Ferizaj me çmimin prej 10.32 euro sipas çmimit të peshuar.

Data: 07/06/2024

[1] Ketij formulari i bashkangjiten edhe letrat standarde te njoftimeve: B42, B45 dhe B46.(shtoni letra njoftuese sipas nevojes).

[2] Në rast të procedurave të kufizuara/procedurave konkurruese me negociata t'i bashkangjiten letrat standarde të njoftimeve: B43 dhe B44.(shto letra standarde sipas nevojës), derisa kolona "Vlera totale e ofertave" nuk plotsohet me te dhena.

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi
B45 - Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm[3]

07/06/2024

Kuvendi Komunal Prizren rrug; Remzi Ademaj pn

Nr. i Prokurimit:	**622**	**2**	**4**	**3539**	**2**	**1**	**1**

Titulli: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**

I/e nderuar(a) *[*Z/Znj]

C.I.K, **Rr.Rexhep Bislimi**, **70000**, **Ferizaj**

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".
Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin për kontrate dhe në dosjen e tenderit.
Kemi kënaqësinë të ju njoftojmë se ju keni dorëzuar [*tenderin ekonomikisht më të favorshëm]* ***[tenderin me çmimin më të ulët të ofertës së përgjeshme]*** si përgjigje ndaj *[njoftimit të kontratës] [ftesës për të dorëzuar tenderët në procedurën e kufizuar] [ftesës për të dorëzuar tenderët në procedurën konkurruese me negociata]* për aktivitetin e prokurimit te lartcekur.
Juve ju është dhënë kontrata me çmimin e saktësuar në tenderin tuaj *OPCIONI:*

C.I.K, **Rr.Rexhep Bislimi**, **70000**, **Ferizaj me çmimin prej 10.32 euro sipas çmimit të peshuar.**

dhe në pajtim me afatet dhe kushtet e dosjes së tenderit. Dhënia e kontratës është e përkohshme dhe nuk përbën një marrëveshje kontraktuale deri në skadimit te intervalit, *gjatë të cilit ofertuesit e pasuksesshëm mund të kërkojnë shqyrtimin e vendimit*.

[3] *Kjo letër është për ofertuesin të cilit i është dhënë kontrata*

B42 - Letër standarde për *[tenderuesin] [kandidatin]* e eliminuar [4]

07/06/2024

Kuvendi Komunal – Prizren rrug; Remzi Ademaj pn

Nr. i prokurimit:	**622**	**2**	**4**	**3539**	**2**	**1**	**1**

Titulli: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës**

/e nderuar(a) *[*Z/Znj]*]*
Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, PRISHTNE

Faleminderit që morët pjesë në procedurën e lartshënuar të prokurimit publik. Procedura është udhëhequr në pajtim me Ligjin për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, siç citohet në vazhdim "LPP ".
[Tenderi juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në *[dosjen e tenderit*] [*dokumentet parakualifikuese]*. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:
[Tenderi i juaj] [Kërkesa e juaj për pjesëmarrje] është administrativisht i papërgjegjshëm:

ARSYETIM

***[Ju jeni diskualifikuar] [Tenderi juaj është refuzua*r] për këto arsye :**

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:
Dëshmia e kërkuar dokumentare: Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional,komercial dhe apo Regjistrin e ndermarjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i TVSH Kërkesa 3.Regjistrimi i Numrit Fiskal Kërkesa 4.OE duhet të jetë i licensuar certifikuar për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë. Kërkesa 5.Licensa nga Ministria e shëndetësisë për shërbime të mjekësisë familjare

[4] *Kjo letër u drejtohet tenderuesve/kandidatëve që janë eliminuar; tenderët e të cilëve janë refuzuar nga pjesëmarrja e mëtutjeshme ngase kanë qenë te pa përgjegjshëm dhe të parregullt (Shto letra njoftuese sipas nevojes).*

- **Operatorit Ekonomik nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, si anëtar i grupit - konzerciumit i mungon LICENSA për për ofrimin e shërbimeve sociale lëshuar nga Ministria e Drejtësisë si në kërkesën 4. (Kusht profesional i kërkuar në pikën III.2.2 Përshtatshmëria profesionale).**

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:
Dështmia 2. OE duhet të posedojë Certifikatën ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara.

- **Operatorit Ekonomik nDONA SH.P.K. Rr. Ndue Përlleshi K.P. . Lok Nr.l. Prishtinë, si anëtar i grupit - konzerciumit i mungon CERTIFIKATA ISO 9001 2015 për operatorin ekonomik që aplikon sistemin e menaxhimit në përputhje me normat dhe veprimtaritë e përshkruara-Ofrimi i shërbimeve të përkujdesjes shëndetësore socio-mjekësore.**

Republika e Kosovës **Komuna e Prizrenit**

Republika Kosova- Kosova Cumhuriyet Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Prizren 13/06/2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prizrenit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.06.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull:
Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës me Nr. të Prok: 622-24-3539-211nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës me Nr. të Prok: 622-24-3539-211** lidhur me *Vendimin për dhënie të kontratës* te AK –së, të datës 07/06/2024 të publikuar ne web-faqe te KRPP-së .
2. Vendimi mbi DHËNIEN e kontratës mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik Ekonomik **Grup i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K.** me datë 11.06.2024 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës me Nr. të Prok: 622-24-3539-211**

Autoriteti Kontraktues, me datë 13.06.2024 , ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

- Pretendimi i OE ankues, lidhur me Kërkesën e Autoritetit Kontraktues në Njoftimin në Kontratë Certifikatë-Licenë për ofrimin e shërbimeve sociale tek Përshtatshmëria Profesionale është JO i bazuar.

Grup i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K. kan aplikuar si grup për këtë projekt, ndërsa OE nDONA SH.P.K. si anëtar i konzorciumit nuk është i licensuar dhe nuk posedon në dosje e tij certifikatën-licensën nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e shërbimeve sociale për këtë projekt shëndetësor.

Me rastin e krijimit të Konzerciumit tek kërkesat e përshtatshmërisë profesionale të përcaktuara me nenin 66 të LPP-së të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues duhet të plotësohen nga të gjithë operatorët ekonomik në mënyrë individuale.

- **Pretendimi i OE ankues, lidhur me Certifikatën e regjistrimit të OE Caritas Kosova është JO i bazuar.**

  OE Caritas Kosova (C.I.K) është i regjistruar në Departamentin e Organizatave Joqeveritare në MPB me nr.të regjistrimit 5200022-0 dhe nr.fiskal 600246765 me emrin: Caritas Kosova dhe me shkurtesa: C.I.K (shih certifikatën)

- **Pretendimi i OE ankues, lidhur me Certifikatën Licensimi për ofrimin e shërbimeve sociale të OE Caritas Kosova është JO i bazuar.**

OE Caritas Kosova posedon me dëshmi Certifikatën Licensimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare si Caritas Kosova me nr.biznesit 5200022-0 me validitet deri më 25/11/2024 lëshuar nga Ministria e Finansave.(sepse në at kohë kjo ministri ka lëshuar këtë certifikata për këto shërbime sociale,tash ministria e drejtësisë).

- **Pretendimi i OE ankues, lidhur me Licensë nga Ministria e shëndetësisë të OE Caritas Kosova është JO i bazuar.**

  OE Caritas Kosova posedon me dëshmi licensën nga minstria përkatëse me shkurtesën C.I.K me nr.5200022-0 e cila shkurtesë C.I.K shkruan edhe në certificate Caritas Kosova me nr.5200022-0.

- **Pretendimi i OE ankues, lidhur me ISO-2015 të OE Caritas Kosova është JO i bazuar.**

  OE Caritas Kosova posedon me dëshmi ISO -20215 dhe ka validet deri më 26/03/2027 për të njajtat shërbime të kërkuara nga Autoriteti Kontraktues me shkurtesën C.I.K si në certifikatën e regjistrimit me nr. 5200022-0.

- **Pretendimi i OE ankues, lidhur me Sigurimin e Tenderit 9.000 euro të OE Caritas Kosova është JO i bazuar.**

  OE Caritas Kosova në dosjen e tij posedon Sigurimin e Tenderit 9.000,00 euro të kërkuar nga Autoriteti Kontraktues me titull dhe me nr. të projektit 622-24-3539-211 si Caritas Kosova dhe me shkurtesën C.I.K si në certifikatën e regjistrimit me nr. 5200022-0 dhe nr.fiskal 600246765.

Duke u mbështetë në këto fakte:

1. Autoriteti Kontraktues, vendos si në dispozitivin e këtij vendimi

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.**

Isa Osmankaj
Udhëheqës i sektorit të prokurimit

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0523

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Agon Ramadani, duke vendosur sipas ankesës së OE OJQ EKO-PROTECTION, kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i planit për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-5689-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit, më 11/10/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e OJQ EKO-PROTECTION me nr. 2023/0523, e datës 26/07/2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Hartimi i planit për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prizrenit", me numër të prokurimit 622-23-5689-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna e Prizrenit.

2. Mbetet në fuqi vendimi i AK- KK Prizren për anulim te procedurës se prokurimit.

3. Në përputhje me nenin 31 pika 6, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, i cili obligohet qe brenda afatit prej 60 ditëve te beje kërkesë per kthim te tarifës ashtu sic parashihet ne Rregulloren e Punës se OSHP-se.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 05.06.2023 ka paraqitur Njoftimin për kontratë - B05, për aktivitetin e prokurimit me titull "Hartimi i planit për zhvillimin e arsimit në Komunën e Prizrenit" me numër të prokurimit 622-23-5689-2-2-1.

Me 19.07.2023, AK ka publikuar B58-Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues me të cilin vendim ka anuluar procedurën e prokurimit në mungesë të ofertave te përgjegjshme.

Me 21.07.2023, OE "OJQ EKO-PROTECTION" ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Operatori ekonomik ankues i pakënaqur me Vendimin e AK-së, me datë 26.07.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është regjistruar me numër protokolli 523/23.

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

Paneli Shqyrtues konstatoi se ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se e njëjta i plotësonte kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 01.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi i AK.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka njoftuar Panelin Shqyrtues se pajtohet me rekomandimet e ekspertit ndërsa Operatori Ekonomik Ankues ka njoftuar se nuk pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave-

Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtresat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka

nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtruesi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

-Konstatimet e ekspertit shqyrtues-

- *Pretendimi i parë (I):* Ankuesi ka deklaruar se Autoriteti Kontraktues Kuvendi Komunal i Prizrenit ka anuluar aktivitetin e prokurimit ne fjale me këto pretendime: Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal. Dëshmitë e kërkuara dokumentare; Evidenca 1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje), (certfikata e biznesit e dorëzuar ne ofertë është OJQ qe nuk përputhet sipas kërkesës se njoftimit për kontratë/DT te vendosur nga AK) ;
- *Përgjigje në pretendimin e parë (I):*Lidhur me pretendimin ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se sa i përket pikës se specifikuar nga OJQ EKO-PROTECTION, AK ne dosjen e tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar: Kërkesa 1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo Regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit Kërkesa 2.Regjistrimi i Numrit Fiskal. Ndërsa për ta dëshmuar ketë kërkesë është kërkuar: Evidenca1 Certifikata e regjistrimit të biznesit me informatat për biznesin (kopje). Evidenca 2 Certifikata e numrit fiskal. Ne lidhje me pretendimin e parë ankimor te OE ankues sqarojmë se ne bazë te LPP-se çdo operator ekonomik mund te beje kërkesë për sqarim për çdo kërkese qe e konsideron te nevojshme. *Neni 53- Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit specifikohet saktë se: "Gjatë përgatitjes së tenderit, çdo operatorë ekonomik mund të bëjë kërkesë me shkrim te autoriteti përkatës kontraktues për çfarëdo informate apo sqarim shtesë që operatori ekonomik beson se është e nevojshme për përgatitjen ose dorëzimin e një tenderi përkatës, me kusht që çdo kërkesë e tillë me shkrim të pranohet nga autoriteti kontraktues brenda afatit te përcaktuar*. Ne zbatim te këtij neni nga ana AK-se ne dosjen e tenderit tek Seksioni II. Fleta e të Dhënave te Tenderit (FTD) pika 16.1 e FDT-se është specifikuar sakte koha për te kërkuar sqarime ne lidhje me aktivitetin ne fjale. Në bazë te dokumenteve dhe dëshmive qe janë te ngarkuara për ketë aktivitet ne platformën e e-prokurimit nuk ka asnjë kërkese për sqarim sa i përket dokumenteve ne fjalë. Andaj ne bazë te LPP-se dhe legjislacionit sekondar ne fuqi qe e rregullon fushën e prokurimit publik Autoriteti kontraktues gjate vlerësimit te ofertave është i obliguara qe vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimi i ofertave te behën ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se. *Ne nenin 59 k amini i, le ë imi d e K a a imi i en e ë e gjegjësisht ne piken 4 te këtij neni specifikohet se:*
  - " tor eti o tra tu s o të o d o ë n ë e er i

  të p g g h m et m n e t n e i në a ë ë htë ë p ut h ëri e të g tha ë e at e ara htruara në n o t n e o trat s d e në d en e te d Ne nenin 40 te rregullores nr.001/2022 për prokurimin publik sqarohet ne detaje se: *40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. 40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.* Ne baze te sqarimeve te specifikuara me larte për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor i Ankuesit është i pa bazuar.

- *Pretendimi i dytë (II) ankimor:* Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së- (mungon Certifikata e TVSH-se);
- *Përgjigje në pretendimin e dytë (II) ankimor:* Sa i përket këtij pretendimi ankimor, eksperti shqyrtues sqaron se AK Kuvendi Komunal i Prizrenit ne dosjen e tenderit tek Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale është kërkuar: Kërkesa 3 OE duhet të jetë i regjistruar në TVSH ose të jetë deklarues i TVSH së. Ndërsa për ta dëshmuar ketë kërkesë është kërkuar: Evidenca 3 Certifikata e TVSH së. Pretendimi i specifikuar sa i përket kërkesës se AK-se për Certifikatën e TVSH-se se në bazë te nenit 27 te ligjit Nr. 05/L -037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar këto shërbime janë te liruar nga TVSH për mendimin e ekspertit shqyrtues OJQ EKO-PROTECTION dhe te gjithë OE e interesuar për aktivitetin e prokurimit ne fjalë është dashur qe te veproj ne përputhje me nenin 53 te LPP-se gjegjësisht nenin 24 te Pas pranimit te ofertave autoriteti kontraktues ne përputhje me nenin 59 te LPP-se është i obliguar qe te gjitha ofertat e pranuara ti vlerësoj ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se, legjislacionit sekondar ne fuqi dhe ne bazë te kërkesave dhe kritereve te përcaktuara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate. Ne baze te sqarimeve te specifikuara me larte për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor i Ankuesit është i pa bazuar
- *Pretendimi i tretë (III) ankimor:* 3. Kërkesa 3 Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme me studime themelore te fushës se arsimit ose te ekonomisë. Te kanë përvojën ne punë. Dëshmi 3 CV-ia, diploma, dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë.(kontrata ose marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë projekti me punëtoret nuk janë original);
- *Përgjigje në pretendimin e tretë (III) ankimor:* Eksperti shqyrtues sqaron se AK Kuvendi Komunal i Prizrenit ne dosjen e tenderit tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale është kërkuar Kërkesa 3 Të ketë së paku 5 të punësuar me profile të ndryshme me studime themelore te fushës se arsimit ose te ekonomisë. Te kanë përvojën ne punë. Ndërsa për ta dëshmuar ketë kërkesë është kërkuar: Dëshmi 3 CV-ia, diploma, dëshmi mbi përvojën në punë, kontrata e punës ose kontrata e bashkëpunimit për ketë projekt me OE në fjalë. Lidhur me arsyetimin e specifikuar nga ana e AK-se se "kontrata ose marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë projekti me punëtoret nuk janë origjinal" eksperti shqyrtues mendon se gjate vlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit AK Komuna e Prizrenit është dashur te veproj ne përputhje te plote me neni 72- Dokumentacioni dhe informacioni shtesë te LPP-se:

1. *Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.*

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

3. Sigurimi i informacionit qe mungon ose ofrimi i informacionit do të aplikohet vetëm për dokumentet ekzistenca e të cilave është e fiksuar, para skadimit të afatit për dorëzimin e tenderëve, dhe mund të verifikohet në mënyrë objektive.

Sqarimi i tenderëve është i rregulluar edhe me Neni 38 Sqarimi i Tenderëve te Rregullore Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, ku sqarohet ne nenin 38.5 Autoriteti kontraktues mund të ftojë Operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojnë çertifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të LPP-se d.m.th dëshmitë e dorëzuara për kërkesat e përshtatshmërisë, kërkesat e përshtatshmërisë profesionale, gjendjes ekonomike dhe financiare dhe aftësisë teknike dhe profesionale, çertifkatat e kualitetit, kërkesat e grupeve të OE. Ne baze te sqarimeve te specifikuara me larte për mendimin e ekspertit shqyrtues pretendimi ankimor i Ankuesit është i bazuar.

Eksperti shqyrtues sqaron se duke u bazuar ne analizën e fakteve/dëshmive te dokumentuara ne platformën elektronike ne e-prokurim, rrjedhjen dhe procedurën e prokurimit me këtë aktivitet te prokurimit vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi i ofertave është ne përgjegjësi dhe ne diskrecion te Autoriteti Kontraktues qe te behën ne harmoni te plote me dispozitat ligjore te LPP-se dhe legjislacionit sekondar, ne mënyrë qe te respektohen kërkesat e përzgjedhjes, specifikimet teknike Aneksi 1 ne dosjen e tenderit si dhe te respektohen ne përpikëri kriteret e dhënies te specifikuara ne dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Te gjithë operatoret ekonomik për çdo kërkese apo paqartësi qe e kanë në lidhje me kërkesat e dosjes se tenderit munden te bëjnë kërkesë për sqarim ne përputhje me nenin 53 te LPP-se.

-Konstatimet dhe përfundimet e panelit Shqyrtues-

Me qellim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, Paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues dhe Autoritetit Kontraktues.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat për të pretendohet nga operatori ekonomik ankues. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Më tej paneli shqyrtues vlerëson se anulimi i procedurës së prokurimit nga AK është bërë në harmoni me nenin 62 të LPP-së, pasi që në mungesë të ofertave të përgjegjshme AK ka qenë e detyruar, potencialisht të anulojë procedurën e prokurimit. Paneli Shqyrtues konsideron se rrjedha e aktivitetit të prokurimit, karakterizohet në përputhje me dispozitat ligjore, të cilat në raport me qëllimin e synuar të këtij aktiviteti të prokurimit, nga pikëpamja e këtij Paneli, janë implementuar me kujdesin e shtuar dhe në mënyrë profesionale.

Nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit, është gjetur se pretendimi i parë

është i pabazuar. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin rekomandimeve të ekspertit shqyrtues që ka vlerësuar se në dosje të tenderit nuk ka asnjë kërkesë për informata dhe sqarime shtesë, andaj paneli shqyrtues e vlerëson si të bazuar ekzaminim dhe vlerësimin e tenderit me c'rast edhe është konsideruar si i papërgjegjshëm operatori ekonomik në këtë pikë të ankesës së tij.

Pas shqyrtimit dhe analizimit të deklarimeve dhe pretendimeve të palëve në procedurë, PSH ka arritur në konstatimin përfundimtar se OE ankues nuk ka arritur që të vërtetojë përgjegjshmërinë e ofertës së tij në aspektin e përmbushjes së kritereve të kërkuara në DT, për faktin se i njejti nuk ka certifikatën e TVSH-së konform kërkesës, për të arritur deri tek kjo mënyre vendosje nga ana e panelit janë konsideruar edhe rrethanat tjera përcaktuese, duke filluar nga fakti se ky kriter ka qenë i përpiluar qartë dhe i kuptueshëm, që nënkupton se vetëm deklaruesit e TVSH-së mund të jenë pjesëmarrës në këtë aktivitet prokurimi duke përjashtuar OE-të që nuk janë deklarues, si dhe siç është evidentuar në e-prokurimi, OE ankues si dhe OE tjerë pjesëmarrës nuk kanë shfrytëzuar mundësinë që para ofertimit të ngrisin këtë çështje duke kërkuar sqarime apo edhe duke inicuar kërkesë për rishqyrtim të kritereve, për faktin se të gjithë OE të interesuar për ofertim në aktivitete prokurimi, në raste kur pretendohet lidhur me kritere diskriminuese, të paqarta apo pretendime tjera lidhur me kërkesat e përpiluara ne DT nga ana e AK, kanë mundësinë që të kërkojnë sqarime e poashtu të iniciojnë procedura ankimore (kërkesë për rishqyrtim, ankesë në OSHP), në periudhën para ofertimit, siç përcaktohet me legjislacionin në fuqi, ndërsa me rastin e ofertimit nënkuptohet se palët veçse janë pajtuar me kriteret ne DT dhe NJK pasi që të njejtit kanë paraqitur ofertat e tyre, kështu që PSH ka arritur në konstatimin përfundimtar se në këtë rast OE ankues nuk ka plotësuar kërkesat e parapara në DT dhe në rastin konkret kemi të bëjmë me aplikimin e nenit 59, paragrafi 4 i LPP-së, i cili saktëson se: "*Autor eti o tra tu s o të o d o ë n ë e er i*
të p g g h m et m n e t n e i në a ë ë htë ë p ut h ëri e të g tha ë e at e ara htruara në
n o t n e o trat s d e në d en e te d

Paneli shqyrtues për të arritur deri tek kjo mënyrë vendosjeje ka konsideruar se ndër rrethanat kryesore përcaktuese ka qenë fakti që ndonëse legjislacioni në fuqi, konkretisht neni 4 pika 1.19 saktëson se edhe organizatat e shoqërisë civile konsiderohen operator ekonomik e poashtu fakti që ankuesi i ju është referuar legjislacionit rregullues lidhur me lirimin nga TVSH, por me qenë se lidhur me këto çështje sipas nenit **132/A të LPP-së mbi Kontraktimin e shërbimeve nga OSHC-të përcaktohet që:***Qeveria e Republikës së Kosovës me akt nënligjor përcakton rregullat, standardet dhe procedurat e kontraktimit të shërbimeve publike për organizatat e shoqërisë civile.* Ndërsa në rastin konkret është konsideruar nga ana e panelit se pala ankuese nuk ka arritur që të sigurojë fakte, argumente dhe prova të mjaftueshme që vërtetojnë se norma e referuar aplikohet lidhur me rastin relevant.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet të refuzohet si pjesërisht e bazuar për faktin se Ankuesi ka të drejtë në pretendimin e tij të tretë (III) lidhur me Kërkesat mbi mundësitë

teknike dhe/ose profesionale-kërkesa 3, sepse paneli shqyrtues në vlerësimin e tij të pavarur konsideron se AK ka qenë dashur që të veprojë sipas nenit 72 të LPP-së, duke kërkuar sqarime shtesë lidhur me "kontrata ose marrëveshjet e bashkëpunimit për këtë projekti me punëtoret".

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues- Komuna e Prizrenit për anulim të aktivitetit të sipërcituar të prokurimit.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **OJQ EKO-PROTECTION**
- Arkivës së OSHP-së:

Banka Ekonomike

Payments:

Type	Id	Beneficiary	Amount	Ccy	Executio	Status
	2305871	Organi Shqyrtues i Prokurimit	5,000.00	EUR	19/06/20	Executed

Details

Name/Surname: Kastriot Asllani

Company: Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA

Description: Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf

UNIREF: PPQDD1111111111H

Amount EUR 5,000.00

Customer 128186 KOSOVAMED HEALTHCARE SH.P.K.

Account XK051401000012818632 EUR LLOGARI RRJEDHESE

Execution Single execution on 19/06/2024, if account balance sufficient

Single advice, single booking.

Current 60/60

1) 60/60 (1009558132 - 19/06/2024)

Banka Ekonomike

Payment list

Contract	128186
User	**1009558132**
Printed on	**19/06/2024 15:43**
Payments status	
Totals	**5,000.00 EUR**

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
KUVENDI I KOSOVËS / SKUPŠTINA KOSOVA / ASSEMBLY OF KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
PROCUREMENT REVIEW BODY

UNIREF

PPQDD1111111111H

PAGESE PËR DEPOZITË PËR SIGURIM TË ANKESËS
PLAĆANJE ZA SIGURNOST DEPOZITA ŽALBE
PAYMENT FOR THE SECURITY DEPOSIT OF THE COMPLAINT

Të dhënat e OE Podaci EO EO data	Grupi i Operatorëve Ekonomik KosovaMed Healthcare SH.P.K.; nDONA SH.P.K, Rr. Ndue Përlleshi K.P. , Lok. Nr.1, Prishtinë, 10.000 PRISHTINË
Përshkrimi Opis Description	Blerja e shërbimeve shëndetësore për përmbushjen e nevojave për staf shtesë të institucioneve të KPSH-ës
Numri i prokurimit Broj nabavke Procurement number	622-24-3539-2-1-1
Shuma / Iznos Ammount	€ 5000 Euro 00 Ct Data / Datum / Date
Me fjalë / Rečima In words	5 0 0 0 0 0
Xhirollogaria Broj žiroračuna Bank account	1 0 0 0 4 3 0 0 7 0 0 0 5 7 5 6
Lëshuar nga Izdato od / Issued by	OSHP

Nënshkrimi dhe vula e bankës
Potpis i pečat banke
Bank signature and stamp

14.2 Ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, të gjithë ankuesit duhet të paguajnë një tarife te ankesave ne OSHP. a. Kurdo qe ankesa ndërlidhet me vendimin për shpërblim te një kontrate, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës së ofertës, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro. b. Kurdo qe aneksa nderlidhet me njoftimin për kontratë, dokumentet e tenderit, shuma e tarifës se ankesës është e barabartë me një përqind (1%) te vlerës se parashikuar, por jo më pak se 100 Euro dhe jo më shumë se 5,000 Euro.	14.2 U skladu sa članom 118 ZJN, svi podnosioci žalbe moraju platiti žalbu u TRN. a. Kad god se žalba odnosi na odluku o dodeli ugovora, iznos žalbene naknade iznosi jedan procenat (1%) od vrijednosti ponude, ali ne manje od 100 € i ne više od 5.000 €. b. Kad god se aneks odnosi na obaveštenje o ugovoru, tenderska dokumentacija, iznos naknade za žalbu iznosi jedan procenat (1%) od procenjene vrednosti, ali ne manje od 100 evra i ne više od 5.000 evra.